



SHPJEGIME METODOLOGJIKE:

Turizmi paraqet shumë e raporteve dhe dukurive që dalin nga udhëtimi dhe qëndrimi i turistëve në një vend, ku udhëtimi dhe qëndrimi i tillë nuk do të bazohet në banim të përhershëm dhe nëse me to nuk është e lidhur kryerja e ndonjë veprimtarie ekonomike.

Turizmi ndërkombëtar paraqet shumë të raporteve dhe dukurive që rezultojnë në momentin kur turisti kalon kufirin shtetëror dhe qëndron në vendin tjetër më së paku një natë për shkaqe pushimi, rekreacioni apo ngjashëm.

Turist paraqet çdo person, i cili qëndron përkohësisht në një vend jashtë vendit të banimit të përhershëm dhe atje kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodimi.

Turist vendas paraqet person me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në vend tjetër jashtë vendbanimit të përhershëm dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodimi për turistët.

Turist i huaj paraqet person me vendbanim të përhershëm jashtë Republikës së Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në Republikën e Maqedonisë dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në objekt tjetër akomodimi për turistët¹.

TË DHËNA STATISTIKORE

PËR NUMRIN E TURISTËVE DHE BUJTJEVE TË REALIZUARA NË KOMUNËN E STRUGËS
 PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR-DHJETOR 2018

Në bazë të të dhënave statistikore², numri i turistëve në vitin **2018** në Komunën e Strugës ka qëndruar gjithsej **106 541** turistë, prej të cilëve **52 633** janë turistë vendas, kurse numri i turistëve të huaj ka qenë **53 908** turistë. Në vitin 2018 janë realizuar gjithsej **404 755** bujtje, prej të cilave **256 741** nga ana e turistëve vendas, kurse turistët e huaj kanë realizuar gjithsej **148 014** bujtje.

Tabela nr. 1, Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2018

Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara për vitin 2018	Turistë			Bujtje të realizuara		
	Gjithsej	Vendas	Të huaj	Gjithsej	Vendas	Të huaj
Gjithsej	106 541	52 633	53 908	404 755	256 741	148 014

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Shkup, 2019

Sipas numrit të turistëve të huaj që kanë qëndruar në Strugë në vitin 2018, vendin e parë e kanë zënë turistët nga **Republika e Turqisë** me **7 374** turistë, në vend të dytë **Polonia** me **6 605** turistë, kurse në vend të tretë është **Republika e Kosovës** me **6 158** turistë. Nga gjithsej **53 908** turistë të huaj, **20 137** turistë (gjegjësisht **37.3%**) bëjnë pjesë nga shtetet e lartpërmendura. Sipas numrit të bujtjeve të realizuara, nga gjithsej **148 014** bujtje, në vend të parë ka qenë **Mbretëria e Holandës** me **28 669** bujtje, në vend të dytë **Republika e Polonisë** me **24 715** bujtje, kurse në vend të tretë **Republika e Izraelit** me **18 366** bujtje të realizuara. Shtetet që përmenden më lartë marrin pjesë me **48.5%** në numrin e përgjithshëm të bujtjeve të realizuara (**71 750 bujtje**).

Në vazhdim të këtij teksti do të paraqiten të dhënat për turistët e huaj që më së shumti e kanë vizituar dhe kanë qëndruar në Komunën e Strugës në vitin 2018, në rang-listë prej dhjetë shteteve.

¹ Definicionet për turistin, turistin e vendit dhe turistin e huaj janë dhënë në bazë të shpjegimeve metodologjike që jep Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup (për informacione më të hollësishme kliko në ueb-faqen e këtij enti: www.stat.gov.mk).


² Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Të dhëna statistikore për Komunën e Strugës, Shkup, 2019, faqe 1.

Tabela nr. 2, Numri i turistëve të huaj dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2018

Rang	Shteti	Numri i turistëve	Rang	Shteti	Bujtje të realizuara
1.	Turqia	7 374	1.	Mbretëria e Holandës	28 669
2.	Polonia	6 605	2.	Polonia	24 715
3.	Kosova	6 158	3.	Izraeli	18 366
4.	Shqipëria	5 974	4.	Kosova	9 797
5.	Izraeli	4 558	5.	Turqia	9 605
6.	Mbretëria e Holandës	4 365	6.	Belgjika	9 326
7.	Bullgaria	2 293	7.	Shqipëria	8 865
8.	Belgjika	1 452	8.	Bullgaria	4 590
9.	Serbia	1 124	9.	Serbia	3 133
10.	Greqia	1 034	10.	Greqia	2 451
Gjithsej:		40 937	Gjithsej:		119 517

Nga gjithsej **53 908** turistë të huaj që kanë qëndruar në Strugë gjatë vitit 2018, **40 937** turistë ose pothuajse **76%** i përkasin turistëve që vijnë nga dhjetë shtetet e lartpërmendur. Sa i përket bujtjeve të realizuara nga ana e turistëve të huaj (**148 014 bujtje**), mbi **80.7%** të bujtjeve iu përkasin këtyre turistëve (**119 517 bujtje**).

Paraqitja grafike nr. 1, Numri i turistëve sipas muajve të vitit 2018



Paraqitja grafike nr. 2, Bujtje të realizuara sipas muajve të vitit 2018

